



Ndërmarrja Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A. Podujevë

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 po ashtu në bazë të dispozitave të nenit 21.1, neni 21.4 po ashtu neni 25 paragrafi 25.2 pika h) të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike respektivisht neni 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, si dhe neni 5 të Udhëzimit Administrative nr. 01/2024 për procedurat e rekrutimit, Komisioni i Auditimit të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A. Podujevë, në mbledhjen e mbajtur më datë: 05.03.2026 morrëm vendim që të shpallim:

KONKURS PUBLIK

Datë: 10.06.2026

Nr.Prot:141/III

Për plotësimin e vendit të lirë të punës
Auditor i Brendshëm (1) Pozitë

Titulli i Punës: Auditor i Brendshëm

Raportimi: Komisionit të Auditimit

Vendi i punës: NPL “Eko-Llapi” Sh.A Podujevë

Niveli i pagës: 3

Mandati: 3 vjet

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Udhëheqjen, menaxhimin dhe organizimin e brendshëm të Zyrës së Auditimit,
- Përpilimi i procedurave të auditimit, gjegjësisht planit të auditimit të brendshëm për të gjitha transaksionet e NPL, komfort objektivave të kontrollit të brendshëm, politikave dhe procedurave të NPL të bazuara në Ligjin e aplikueshëm,
- Auditimi i planeve investive dhe financiare të NPL, planit vjetor të biznesit dhe buxhetit vjetor,
- Auditimi i pasqyrës vjetore të bilancit dhe deklaratat e fitimeve dhe humbjeve si dhe deklaratat financiare që kërkohen me Ligj,
- Verifikimi objektiv dhe shfrytëzimi efektiv i burimeve të NPL, si dhe dhënia e rekomandimeve adekuate për Komisionin e Auditimit,
- Verifikimi i përshtatshmërisë dhe funksionimi i rregullt i sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga NPL, të gjitha Ligjeve të aplikueshme në Kosovë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe ti siguroj Komisionit të Auditimit çfardo vërejtje apo sugjerime të cilat konsiderohen të nevojshme,
- Verifikimi i rregullt i përshtatshmërisë dhe funksionimi i rregullt i sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i NPL, duke përfshirë dokumentacionin financiar mbahet në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe me Ligjin dhe që projekt deklarata vjetore financiare të përgatiten në mënyrë të rregullt,
- Analiza e sistemeve dhe proceseve të biznesit dhe kontrolleve të ndërlidhura me to,
- Ofron këshilla për çështje të auditimit të brendshëm brenda institucionit, sipas nevojës,
- Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon me autoritetet e jashtme sipas nevojës,
- Raportimi i rregullt para Komisionit të Auditimit dhe përmbushja e çfardo detyre të përcaktuar nga Komisioni i Auditimit.
- Detyra tjera relevante.

Kushtet dhe kulaifikimet e kërkuara:

Kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 të Ligjit nr. 03/L- 087 për Ndërmarrjet Publike të plotësuara dhe ndryshuara me Ligjin nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe po ashtu secili kandidatë duhet të përmbushë të gjitha kushtet e pavarësisë ashtu sikurse parashihet në nenin 17.2 (d), (f), (j) (k), (l) të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Përveq këtyre kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushte të veqanta,

- Të ketë Diplomë universitare në ekonomi, kontabilitet apo fusha të tjera të studimeve relavante për sektorin që do të auditohet,
- Të jetë i certifikuar si auditor i brendëshëm nga Institucionet e licencuara në vend ose jasht tij.

Njohuritë dhe shkathtësitë profesionale

- Njohuritë e qasjeve moderne në planifikim dhe kontroll,
- Njohuritë të Ligjeve, Rregulloreve dhe Udhëzimeve Administrative të aplikueshme,
- Shkathtësi të komunikimit, planifikim të punës dhe udhëheqjes të aktiviteteve të Auditimit,
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësues dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale,
- Shkathtësi organizative në përcjellën e zbatimit të rekomandimeve me qëllim të realizimit të tyre në kohë,
- Shkathtësi kompjuterike në programet: Microsoft, Word, Excel, Acces,
- Njohja e gjuhës angleze është e preferuarar.

Kandidati/ja duhet t'i dorzojë këto dëshmi:

- Aplikacioni i Ndërmarrjes
- Dokument identifikues (letërnjoftim ose pasaportë)
- Kopja e diplomës së Fakultetit
- Çertifikatën që nuk jeni nën hetime nga Gjykata (jo më e vjetër se gjashtë muaj)
- Çertifikatë e auditorit të brendëshëm në sektorin publik (përparësi)
- Referencat, si dhe certifikatat tjera profesionale
- Përvojën e punës së paku 2 vite e dëshmuar.

Procedura e aplikimit

- Aplikimi për këtë konkurs bëhet vetëm në mënyrë elektronike, në përputhje me Udhëzimin Administrativ (UA) Nr. 01/2024.
- Kandidatët e interesuar obligohen që dokumentacionin e kompletuar të aplikimit ta dërgojnë ekskluzivisht përmes email-it, në adresën zyrtare:
- **✉ Konkursenplekollapi@gmail.com**
- Dokumentet duhet të jenë të skanuara qartë dhe të dërgohen në një email të vetëm, brenda afatit të përcaktuar të konkursit. Në subjektin (subject) të email-it duhet të shënohet pozita për të cilën aplikohet.
- Kandidatët janë të obliguar të shënojnë saktë të dhënat personale, adresën dhe numrin kontaktues të telefonit.
- Kandidatët janë të obliguar që aftësitë dhe kualifikimet e deklaruara t'i dokumentojnë me dëshmi përkatëse (certifikata, dëshmi përvojë, etj).
- Aplikacioni shkarkohet nga faqja zyrtare në facebook: **NPL "Eko-Llapi" Sh.A.**
- Vetëm kandidatët e përzgjedhur bazuar në kritere do të ftohen në fazat e mëtejme të rekrutimit. Njoftimet lidhur me kohën dhe vendin e mbajtjes së rekrutimit do të publikohen në faqen zyrtare në facebook: **NPL "Eko-Llapi" Sh.A.** dhe në tabelën e shpalljeve në "Ish Objekti i Komunës".
- Afati për aplikim është i hapur për të gjithë kandidatët nga data:11.06.2026 deri më: 25.06.2026 ora 16:00

Sqarime

- Aplikacionet e pakompletuara ose ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.
- Kandidati/ja i/e përzgjedhur, para nënshkrimit të kontratës, obligohet të dorëzojë certifikatën mjekësore që vërteton gjendjen e mirë shëndetësore fizike dhe psikike.

Kryesuesi i Komisionit të Auditimit

Besnik Mehmeti

